



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Data 01.08.2023

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** ”RIPARIMI I PJESSHËM I SHKOLLAVE NËN  
ADMINISTRIMIN E BASHKISË ROSKOVEC”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Riparim dhe  
renovim-45453000-7;Sherbime te riparimit dhe mirembajtjes-50**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5 265 425( pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e  
katërqind e njëzetë e pesë) lekë pa tvsh.**

**Argumentimi i fondit limit:**Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj”, Komisioni për llogaritjen e cmime është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015,(ndryshuar me VKM-në nr.631,datë 26.10.2018 ,me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.Bashklidhur dosjes: relacioni i komisionit të llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike mbi argumetimin e fondit limit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shkolla e Magjistraturës ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*1. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*2. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1-** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021,2022 të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nënshkrim dhe vule. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitit*. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* (i ndryshuar).

**2- Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare 2021-2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 2 106 170 lekë pa tvsh**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

Duke patur në konsideratë vlerën e objektit të prokurimit:” **”RIPARIMI I PJESSHWM I SHKOLLAVE NWN ADMINISTRIMIN E BASHKISW ROSKOVEC”** ”pika 3 e nenit 77 të LPP dhe sipas parashikimeve në nenin 43, pika 1 dhe 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku parashikohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar..”, si dhe mbi bazën e nenit 29, të ligjit nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.”, si pika 1 dhe 2/c, në zbatim të nenit 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe nenit neni 41, gërma ”c” të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

**3.Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 në zbatim të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).**

*Ky kriter permbushet nepermjet paraqitjes se Formularit permbledhes te Vetedeklarimit sipas shtojces 8 ne DST.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia ROSKOVEC, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

#### **2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 1 200 000 lekë dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose –

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se, 4 100 000 lekë pa tvsh.

#### **Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.**

#### **Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:**

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:
  1. Formular vlerësimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës perkatese;
  2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
  3. Situacionin përfundimtar të objektit;
  4. Aktin e kolaudimit; *(në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)*
  5. Fatura tatimore

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;

2. **Situacionin përfundimtar të objektit;**
3. **Aktin e kolaudimit; (në rastet kur ky dokumentacion lëshohet)**
4. **Fatura tatimore përfundimtare.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet. .

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:** Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a(1,2,3,4,5) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Autoritetet Kompetente, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:**

N.P – 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.S- 2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

N.S – 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme

N.S.- 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor tënevojshëm për të ndërë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga organet kompetente shtetërore.”, si dhe në klasifikimin e niveleve (gërmave) për punimet sipas natyrave respektive, të parashikuara në VKM Nr.42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar,

Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve në kategorinë p
			Niveli A	

1. Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

2.3.3-Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 10 (dhjetë) punonjesish të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimum për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

*Numri i punonjesve është llogaritur në bazë të zberthimit të preventivit të grafikut të punimeve dhe natyrës së objektit, numri prej 10 personash përfshin punonjës të specializuar/të kualifikuar si dhe numrin e punëtorëve të thjeshtë përlogaritur nga zberthimi i preventivit, dhe natyrës së objektit.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca 8. Ndërsa operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, për periudhën e fundit të deklaruar.

- Listë pagesat e punonjësve të konfirmuar nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën fundit të deklaruar.

**Argumentim:** Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 8 është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

**2.3.4-** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij specialistë të certifikuar sipas profesioneve, të pakten si me poshte:

- Teknik ndërtimi 1 (një)
- Hidraulik 2 (dy)
- Elektracist 1 (një)
- Bojaxhi 2 (dy)
- Marangoz 2 (një)



**Argumentimi:** *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

*Së dyti*, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” .

*Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.*

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, bëron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

*Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2 kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit 1(një) inxhinier ndërtimi sipas pikës 2.3.5, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.1(një) inxhinier ndërtimi është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

**2.3.5-Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 1(NJE) shofer , , për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (të vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).**

**Shënim:** Për pikat më sipër konkretisht **2.3.4 - 2.3.5**, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin:

Formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pare duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar , Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Njësia e Prokurimit duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve; makineritë që do të kërkohen për realizimin e punimeve (Shtojca 8) si dhe Preventivin e Punimeve shtron nevojën që Ofertuesit të kenë të punësuar Manovrator me qëllim realizimin e kontratës me sukses. Numri i këtyre punonjësve është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Gjithashtu me qëllim nxitjen e garës është përcaktuar rasti përjashtimor ku për Manovratorët që janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.

*Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

**2.3.7-Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë.**

- Kandidati/ofertuesi duhet te disponoje makinerite dhe mjetet si vijon ne pronesi ose me qera.

<b>• I.MAKINERI</b>	<b>Njesia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Pronesia</b>
Automjet transporti vetëshkarkues mbi10 ton.	copë	1	Pronësi ose me qera
Autobot uji.	copë	1	Pronësi ose me qera
Skela	M3	500	Pronësi ose me qera

-Kokore minimumi 10 copë

-Kompletë i ndihmës së shpejtë minimumi 4 copë

- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

-Jelekë fosforeshentë 10 copë

- Karrocë-dore 2 copë

Ndërsa operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronësinë e mjetit:- çertifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit e vlefshme dhe fotot përkatëse;
- (b) Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e noterizuar e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin përkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.
- (e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fituese nga autoriteti kontraktor,. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mesipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zerave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit mundësi të manovrimit me mjete të renda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky

dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit

**2.3.8-** *Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) per objektin qe prokurohet, si me poshte*

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

**2.3.9** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 1(NJE) muaj kalendarike.*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3. **Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.**

2.3.9- Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

**Argumentimi** :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

**Ky kriter vendoset me qëllim dhënien e kësaj kontrate një operatori ekonomik i cili nuk i ka sjell problematika në zbatimin afatit dhe kushteve të përcaktuar në kontrat apo shkatuar dëme kundrejt Bashkisë Roskovec gjatë zbatimit të kontratave të mëparshme.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

\*\*\*

U ra dakort nga antaret e njesisë se prokurimit te ngritur me urdher te titullarit te autoritetitkontraktor,**nr.87,datë.25.07.2023**, për këto kërkesa për kualifikim sepse kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: ”RIPARIMI I PJESSHWM I SHKOLLAVE NWN ADMINISTRIMIN E BASHKISW ROSKOVEC”

**Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur e thjeshtuar, me fond limit: 5 265 425( pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e njëzetë e pesë),**Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

#### **SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:**

*Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes, bashkengjitur DST ne SPE.*

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Anëtarët pranuan specifikimet teknike të hartuara nga Komisioni i posacëm :**KLLFLST( Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)**i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.**4441 prot,datë 14.07.2023**, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve për realizimin e objektit te prokurimit .

**Argumentimi:Specifikimet teknike jane hartuar nga specialistet e fushes konkretishtë nga KLLFLST ,dorëzuar dokumentacioni teknik dhe preventivi me procesverbalin e komisionit nr. 4441/1 prot,datë 21.07.2023, dhe shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe materialeve,Komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe preventivimit është bazuar në VKM-në Nr.629,DATë15.07.2015”PËR MIRATIMIN E MANUALEVE TEKNIKE TË ÇMIMEVE TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË ANALIZAVE TEKNIKE TË TYRE1 (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018)**

**Preventivi I hartuara nga KLLFLST si mëposhtë për objektin:**

Objekti: ”RIPARIMI I PJESSHËM I SHKOLLAVE NËN ADMINISTRIMIN E BASHKISË ROSKOVEC”

Nr	Nr anal	Pershkrimi i punimeve	Njesia	Sasia
	<b>1</b>	<b>Shkolla Gjinnazi "Adem Vrapi" Roskovec</b>		
1	2.388/1	F.V dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	6
2	treg	F.V bravo dyersh	cope	5
3	treg	F.V Grup lavamani	cope	3
4	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	3

5	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	3
6	treg	F.V priza Shuko	cope	4
7	treg	F.V Celsi i thjeshte	cope	4
8	2.485/a	F.V priza bivalente 220V, 10A, 2P-T	cope	10
9	treg	F.V Galixhan kasete shkarkimi	cope	3
		<b>Shuma 1</b>		
	<b>2</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Alush Grepcka" Roskovec</b>		
1	2.404	Boje hidroplastike	m2	5450
2	treg	F.V bravo dyersh	cope	6
3	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	2
4	treg	F.V kasete shkarkimi	cope	2
5	treg	F.V galixhan kasete shkarkimi	cope	4
6	treg	F.V grup lavamani	cope	2
7	2.504	F.V WC allaturka importi	cope	1
8	treg	F.V Tubo shkarkimi per lavamanet	cope	3
9	treg	F.V mekanizmi i shkarkimit te kasetes	cope	3
10	treg	F.V Priza Shuko	cope	15
11	treg	F.V portollampa	cope	20
12	treg	F.V Llampa	cope	25
13	treg	F.V fashature dere 7*2200 mm	cope	75
		<b>Shuma 2</b>		
	<b>3</b>	<b>Kopshti me dreke "Lulet e Jetes"</b>		
1	treg	F.V spiratori i kuzhines	cope	1
2	treg	F.V bravo dyersh	cope	2
3	treg	F.V kasete shkarkimi	cope	5
4	treg	F.V galixhan kasete shkarkimi	cope	5
5	treg	F.V grup lavamani	cope	2
6	treg	F.V WC allaturka importi	cope	1
7	treg	F.v tubo shkarkimi per kondicionerit	ml	7
		<b>Shuma 3</b>		
	<b>4</b>	<b>Sistemim rrethimi i Cerdhes Roskovec.</b>		
1	3.837	Tel gabion per rrethimin ekzistues	m <sup>2</sup>	60
2	4.3	F.V katror/tubo hekuri d=10 cm per perforcimin e rrethimit ekzistues, cdo 5 m, 2m	ton	0.05
3	4.3	F.V katror/tubo hekuri d=10 cm per rrethimin e ri	ton	1.2
4	An	F.V porte metalike dekorative rreshqitese	m <sup>2</sup>	10
5	2.117/1	Kollona b/a per fiksimin e portes	m <sup>3</sup>	1.5
6	3.167	Hekur per kollanat	kg	20
7	2.129/1	Beton c=16/20 per fiksimin e tubove	m <sup>3</sup>	1
		<b>Shuma 4</b>		
	<b>5</b>	<b>Godina e kopshtit Jagodine</b>		

1	2.404	Boje hidroplastike	ml	450
2	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m2	120
3	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	1
4	treg	F.Vkaseta shkarkimi	cope	2
5	2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	2
6	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	2
		<b>Shuma 5</b>		
	<b>6</b>	<b>Shkolla 9- vjecare  "Jashar Muhameti"Vlosh</b>		
1	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat importi	m2	451
2	2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3	12.5
3	2.273	Shtrese pllaka mermeri t=3cm (shkallet)	m2	30.3
4	2.404	Boje hidroplastike	m2	1850
5	2.310	Riparime suvatimi	m2	35
6	treg	F.V Kaseta shkarkimi	cope	2
7	Treg	F.V xhama	m2	1
8	treg	F.V bravo dyersh	cope	5
9	2.504	F.V WC allaturka importi	cope	1
10	treg	F.V galixhan kaseta shkarkimi	cope	3
11	treg	F.V grup lavamani	cope	2
12	treg	F.V priza Shuko	cope	10
13	treg	F.V celsa te thjeshte	cope	14
14	treg	F.Vportollampa	cope	15
15	treg	F.V llampa	cope	30
16	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	2
		<b>Shuma 6</b>		
	<b>7</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Sabri Refiti"Ngjeqar</b>		
1	treg	F.V bravo dyersh	cope	5
2	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	2
3	treg	F.V kaseta shkarkimi	cope	3
4	treg	F.V galixhan kaseta shkarkimi	cope	2
5	treg	F.V rubineta cezme	cope	4
6	treg	F.V grup lavamani	cope	2
7	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	4
		<b>Shuma 7</b>		
	<b>8</b>	<b>Godina e kopshtit fshatit Mbers</b>		
1	treg	F.V Grup lavamani	cope	1
2	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	1
3	treg	F.V kaseta shkarkimi	cope	2
4	treg	F.V llampa	cope	5
		<b>Shuma 8</b>		
	<b>9</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Rexhep Kothere" Kuman</b>		



1	2.404	Boje hidroplastike	m2	335
2	treg	F.V xhama	m2	1
3	treg	F.V bravo dyersh	cope	5
4	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	1
5	treg	F.V mentesha dyersh alumini	cope	30
6	treg	F.V mentesha dyersh druri	cope	21
7	treg	F.V Kasete shkarkimi	cope	2
8	2.504	F.V WC allaturka importi	cope	1
9	treg	F.V galixhan kasete shkarkimi	cope	4
10	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	3
11	treg	F.V rubineta cezme	cope	5
12	treg	F.V priza Shuko	cope	25
13	treg	F.V tapa	cope	40
14	treg	F.V celsi i thjeshte	cope	30
15	treg	F.V portollampa	cope	100
16	treg	F.V llampa	cope	100
		<b>Shuma 9</b>		
	<b>10</b>	<b>Shkolla 9 vjecare "Jorgo Sopiku" Luar</b>		
1	treg	F.V bravo dyersh	cope	7
2	treg	F.V porte metalike dekorative rreshqitese	m2	11
3	treg	F.V bravo dyersh d/alumin	cope	2
4	treg	FV mentesha dyersh druri	cope	12
5	treg	F.V WC allaturka importi	cope	2
6	treg	F.V galixhan kasete shkarkimi	cope	8
7	treg	F.V kasete shkarkimi	cope	2
8	treg	F.V xhama	m2	1
9	treg	F.v grup lavamani	cope	3
10	treg	F.V rubineta cezme	cope	4
11	treg	F.V llampa	cope	8
12	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	25
		<b>Shuma 10</b>		
	<b>11</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Ali Sollaku"Vidhishte</b>		
1	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m2	491
2	treg	F.V Kabell 4*10	ml	55
3	2.404	Boje hidroplastike	m2	1850
4	treg	F.V xhama	m2	2
5	2.522	F.V tub kanalizimi pvc Ø 170 mm	ml	18
6	2.388/1	F.V dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2	4
7	2.485/a	F.V priza bivalente 220V, 10A, 2P-T	cope	9
8	2.485/1	F.V celsa 1 polare 220V 10A	cope	10
9	treg	F.V bravo dyersh	cope	14

10	3.288	F.V hekuri Ø 16 mm per riparimin e rrethimit	ton	0.05
		<b>Shuma 11</b>		
	<b>12</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Zyluftar Veleshnja" Velmish</b>		
1	2.328/1	Riparime suvatimi ( patinim)	m2	200
2	2.403	Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar	m2	250
3	2. a- 125	F.V ndricues fluoreshent 1x60w.IP65	cope	25
4	treg	F.V xhama	m2	1
5	treg	F.V kaseta shkarkimi	cope	2
6	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	5
		<b>Shuma 12</b>		
	<b>13</b>	<b>Shkolla 9 - vjecare "Ajet Toska" Suk 2</b>		
1	2.404	Boje hidroplastike	m2	100
2	2. a- 125	F.V ndricues fluoreshent 1x60w.IP65	cope	30
3	treg	F.V xhama	m2	2
4	treg	F.V kaseta shkarkimi	cope	2
5	treg	F.V tubo shkarkimi per lavamanet	cope	5
		<b>Shuma 13</b>		
		<b>Shuma 1+++13</b>		
		<b>TVSH 20%</b>		
		<b>TOTALI</b>		

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do të paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për t' u firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

## NJËSIA E PROKURIMIT